

Deschamps: Shqiperia eshte nje skuader e mireorganizuar

nga Administrator

E martë, 14 Qershor 2016 20:24



Ne konferencen per shtyp ne prag ndeshjen France - Shqiperi ka folur edhe tranjeri i kombetares franceze Dedier Deschamps. Ai eshte shprehur se ne stadiumin Velodrome te Marsejes tifozet do te jene te shumte ne mbeshtetje te Frances ashtu si edhe te Shqiperise, do te jete nje spektakel i vertete futbollit. Ai ka vleresuar kombetaren shqiptare si edhe punen e bere deri tani nga tranjeri italian Gianni De Biasi. "Shqiperia është një ekip shume i mireorganizuar, dhe De Biasi ka bere nje pune shume te mire. Ekipi i Shqiperise mbron shumë mirë, por jo vetem pasi ka lojtare te shpejte qe kundersonojne shume mire. Kunder Zvicrës, edhe se me 10 lojtare ato kane luajtur shume mire dhe ne fund te takimit mund te barazonin." - eshte shprehur gjate intervistes Deschamps.

I pyetur nga gazetaret se se do te aktivizohen Griezman dhe Pogba, ai eshte shprehur qe nuk ka rendesi kush aktivizohet por fitorja. Por nga seancat stervitore qe ekipi i frances ka bere deri tani, pritet qe te aktivizohet Martial dhe Coman ne vend te Pogba dhe Griezman.